



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 676/1_prot.

Tiranë, më 06 . 05 . 2025

V E N D I M

Nr. 114, datë 06 . 05. 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, është paraqitur ankesa nr. 100 Regj., datë 24.04.2025, e Shoqatës “Për Drejtësi Sociale”, përfaqësuar nga z. Gentian Sejrani., kundër Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, me pretendim diskriminimin për shkak të gjinisë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se:

“Përmes kësaj ankese, dëshirojmë të shprehim shqetësimin tonë të thellë për një deklaratë publike të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, bërë gjatë një takimi elektorale në muajin prill 2025. Në këtë deklaratë, z. Rama shprehet si më poshtë:

“Në këtë fazë jemi më të zgjuar se Anglia, se ata dolën nga BE. Tani prite kur të dalin lajmet në mediat e kënetës që Rama diskriminon anglezët, se ishin mërzitur shumë me atë që u thashë vajzave dje, që partnerëve të tyre duhet t’u vënë kushtin që, nëse votojnë për bufin e kënetës, nuk ia vlejnë, mos ia varni fare.

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Po qe se i doni aq shumë sa të ktheheni tek ata, lërin disa kohë sa të pendohen dhe më pas kthehuni. Ata do shohin pasaportën e BE-së dhe do thonë “rroftë dashnorja ime se të ishte për ne nuk do futeshim kurrë ne BE”. Nuk është shaka, na duhet çdo votë, kështu që fuqinë tuaj tërheqëse për ata djemtë e lëkundur, duhet ta vini në dispozicion të atdheut dhe të votojnë PS-në, në 11 Maj, dhe le të shkruajnë çfarë të duan ata”.

Kjo deklaratë është thellësisht problematike dhe përbën një formë të diskriminimit dhe objektifikimit gjinor. Kryeministri, në vend që t’u drejtohet vajzave si qytetare me të drejta të barabarta, u kërkon atyre të përdorin trupin dhe “fuqinë joshëse” për të ndikuar në votimin e partnerëve të tyre meshkuj. Ky lloj komunikimi nxit objektifikimin e trupit të grave dhe vajzave, duke i reduktuar ato në instrumente për arritjen e qëllimeve politike të një partie.

Kjo është një formë e dhunës simbolike me bazë gjinore, që e sheh gruan si objekt në funksion të dëshirave apo qëllimeve të burrave. Retorika e tillë është jo vetëm seksiste, por e rrezikshme, pasi e banalizon rolin qytetar të grave dhe thellon stereotipet gjinore që ndihmojnë në ushqimin e një kulture të dhunës sistematike ndaj tyre.

Kjo deklaratë bie gjithashtu në kundërshtim me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për fushatat zgjedhore.

Në raportet e Komisionit Evropian dhe OSBE/ODIHR, mbi zgjedhjet në Shqipëri, është theksuar rëndësia e përdorimit të gjuhës gjithëpërfshirëse, respektuese dhe të barabartë ndaj të gjitha gjinive. Rekomandimet e përsëritura kërkojnë nga liderët politikë të shmangin seksizmin dhe të promovojnë barazinë gjinore në diskursin publik. Gjithashtu, Këshilli i Evropës në udhëzimet për gjuhën jo diskriminuese në jetën publike, thekson qartë që zyrtarët duhet të përmbahen nga përdorimi i çdo forme të komunikimit që përçmon apo marginalizon një gjini apo kategori të caktuar sociale.

Përdorimi i një retorike që nxit ndarjen gjinore, promovon stereotipe dhe që përdor trupin e gruas për interesat politike, bie ndesh me frymën e barazisë dhe me parimet që vetë shteti shqiptar është angazhuar të respektojë si pjesë e rrugës së integritetit në BE. “

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri:

- *“Të shqyrtojë këtë rast si një formë diskriminimi gjinor publik dhe institucional;*
- *Të kërkojë një sqarim publik dhe ndjesë nga Kryeministri, për gjuhën e përdorur;*
- *Të ndërmarrë masat e nevojshme për të garantuar që figurat publike të mbahen përgjegjës për gjuhën që përdorin në komunikimet zyrtare dhe publike.”*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD-së, të ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”*.

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen

nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të Ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: *“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”*.

Mbështetur në dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe në kërkesat e përcaktuara në formularin e aplikimit, në rastin kur ankesa paraqitet nga një organizatë me interesa legjitime, asaj duhet t’i bashkëlidhet kopja e vendimit të gjykatës për krijimin e organizatës, kopja e statutit të organizatës dhe kopja e kartës së identitetit.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, evidentohet se për legjitimitimin e shoqatës “Për Drejtësi Sociale” përpara Komisionerit, nga pala ankuese është paraqitur kopje e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e qendrës në gjykatë, si dhe kopje të statutit të qendrës.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 6599, datë 14.12.2020, nëpërmjet së cilit Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, është regjistruar si person juridik, sipas Statutit të saj, konstatohet se objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj Shoqate është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (dhe veçanërisht grupeve: rome-egjiptiane, personave me aftësi të kufizuara, grua, fëmijë, etj).

Bazuar në nenin 3, pika 11, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”*.

Mbështetur në përmbajtjen e aktit të regjistrimit dhe Statutit të Shoqatës, rezulton se forma e organizatës jofitimprurëse, është ajo e Shoqatës, parashikuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqatës, ndër të tjera, është si më poshtë:

- *“Të mbrojnë të drejtat e liritë themelore të çdo personi në Shqipëri (veçanërisht grupet egjiptian, rom, aftësi të kufizuara, grua, besimtarë, etj);*

- Të advokojë dhe të mbrojë, në mënyrë proaktive, së bashku me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri;
 - Të nxisë llogaridhënien e administratës publike në zbatimin korrekt dhe efektiv të legjislacionit nëpërmjet denoncimit publik të cenimit të lirive dhe të drejtave të shtetasve që u përkasin grupeve në nevojë, referimit të tyre tek organet e drejtësisë shqiptare deri në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ose të shkeljeve të kryera, sipas rastit;
 - Të punojë për përmirësimin e legjislacionit, politikave dhe standardeve për të drejtat themelore të njeriut në Shqipëri;
-
- Të kontribuojë në edukimin dhe sensibilizimin e publikut për rëndësinë e mediave në ndërtimin dhe ruajtjen e një demokracie ligjore dhe funksionale;
 - Të promovojë nisma për afirmimin e të drejtave themelore të individëve dhe favorizimin e integritetit mediatik dhe social të kategorive në nevojë, nëpërmjet medias online Informim.al;
 - Të mbështesë me këshillim dhe teknikë mediatike nisma të ndryshme sociale nga komunitete dhe organizata jo fitimprurëse me akses të kufizuar mediatik;
 - Të zhvillojë dhe forcojë bashkëpunimin me partnerë, të tjera subjekte publike dhe private, institucione mediatike, institucione që ushtrojnë veprimtari social-kulturore apo që kanë qëllime të ngjashme dhe që i bashkon misioni dhe qëllimet;
 - Të këshillojë institucione publike dhe subjekte të tjera për çështje të hartimit të politikave të ndryshme mediatike;
 - Të promovojë zhvillimin e gazetarisë qytetare në Shqipëri dhe të fuqizojë zëra të përgjegjshëm qytetarë, sidomos nga grupet në nevojë, në përputhje me vlerat e një shoqërie gjithëpranuese, tolerancës dhe lirive e të drejtave të njeriut.”

Qëllimi kryesor i Shoqatës, sipas parashikimit të bërë në nenin 2, të Statutit, është: “... të punojë për arritjen e zhvillimit të shoqërisë në atë nivel ku qytetarët, pavarësisht nga veçoritë ose dallimet sociale, ekonomike, racore, ideologjike, krahinore, identiteti gjinor dhe në çdo aspekt tjetër midis tyre, ushtrojnë lirisht të drejtat dhe liritë e tyre themelore dhe aksesojnë në mënyrë të barabartë shërbimet publike, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato ndërkombëtare.”

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 6599, datë 14.12.2020, si dhe Statutit të Shoqatës, z. Gentian Sejrani është zgjedhur Kryetar i Shoqatës², i cili bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 10, të Statutit, ka tagrin e përfaqësimit të Shoqatës në marrëdhënie me institucione të ndryshme dhe me persona të tretë, si dhe “Mandati i kryetarit është 3-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje³”.

² Me një mandat 3 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

³ Për analogji citojmë vendimin e KMD -së me nr. 247, datë 23.09.2024.

Bazuar në ankesën e paraqitur, Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, nuk pretendon se është cenuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin gjinor kundrejt grave e vajzave, një prej grupeve të mbrojtura prej saj.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, konstatohet se Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin për të promovuar dhe për të mbrojtur edhe të drejtat e grave dhe vajzave në Shqipëri. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së palës ankuese dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur.

Në analizë të dokumentacionit të sipërcituar, nuk rezulton që nga viti 2020, kur është regjistruar dhe zgjedhur Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës e në vijim, të ketë një akt të rifreskuar të gjykatës në të cilin të jetë rizgjedhur apo ndryshuar Drejtori Ekzekutiv.

Në kuptim për sa sipërcituar, vlerësohet se për legjitimitimin e Shoqatës “Për Drejtësi Sociale”, përfaqësuar nga z. Gentian Sejrani, nevojitet depozitimi i një akti të rifreskuar të gjykatës, ku të provohet se z. Sejrani është rizgjedhur si kryetar i saj.

Në mungesë të aktit të rifreskuar të gjykatës, përmes të cilit provohet se z. Sejrani është rizgjedhur si kryetar i Shoqatës “Për Drejtësi Sociale”, vlerësohet se ai nuk legjitimohet për të paraqitur ankesën pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pika 1 e 2, të nenit 33, të LMD-së, parashikojnë se: *“1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.*

2. Organizata me interesa legjitime mund të kërkojnë kryerjen e hetimeve administrative nëpërmjet disponimit të informacionit të besueshëm, si dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme dhe parashikimeve të bëra në ligjin nr. 10221/2021 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se, Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë pranë KMD-së.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 1 dhe 2, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë ankesa nuk mund të pranohet dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32 dhe nenin 33, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr. 100 Regj., datë 24.04.2025, të Shoqatës “Për Drejtësi Sociale”, përfaqësuar nga z. Gentian Sejrani, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Punoi: R. Hoxha
Pranoi: V. Bushati
Datë: 29.04.2025